

FATOS ÇOÇOLI



Ekspert i Jashtëm pranë KLSH.

Lindur më 1962.

Diplomuar në Ekonomi, dega Marketing. 28 vite eksperiencë pune. Këshilltar në Kryeministri (1994), Këshilltar pranë Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë (2001).

Ka rreth 2 vite pune në KLSH. Ka punuar Drejtor i Departamentit të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit

dhe Teknologjisë së Informacionit (shkurt 2012-shtator 2013). Nga muaji tetor 2013 Ekspert i Jashtëm pranë KLSH.

Fusha e ekspertizës: Financat publike.

“KARTOLINA” E KLSHⁱⁱⁱ

nga Fatos Çoçoli

KLSH më 31 dhjetor 2012 njoftoi qytetarët nëpërmjet mediave se kishte kallzuar në Prokurori kryetarin e bashkisë Pogradec, dy nënkryetarët dhe disa drejtues të tjerë, si zyrtarë të Shtetit që kanë shpërdoruar detyrën, duke shkelur barazinë e pjesëmarrësve në tendera dhe në ankande publike. E bëri këtë, krahas njoftimeve të mëparshme e të mëvonshme për drejtues e ish-drejtimes të lartë të bashkive Himarë, Përmet, Këlcyrë, Sarandë, të komunës Bërzhitë, apo të Komisionit të Prokurimit Publik, kryetari i të cilit emërohet nga Kryeministri. Pra janë zyrtarë edhe të PD-së, edhe të PS-së, edhe të LSI-së. Ky institucion kontrolli nuk po bën dallime. Pak ditë më vonë, kryetari i bashkisë së Pogradecit ankohet në një media për këtë “kartolinë” që ky institucion kushtetues i kishte dërguar pikërisht në ditën e ndërrimit të viteve. Ankesa shoqërohet me tiradën e tij të pafajësisë dhe të mendimit se institucioni më i lartë llogarikërkues në vend i ishte qepur kot së koti. Shumëkush nga ata menaxherë të së mirës publike që kontrollohen nga KLSH do të ankohet, kjo është e natyrshme. Në mbrojtje të vetes, disa të

kapur me presh në duar do të bëjnë të pafajshmit. Do të ketë dhe prej tyre që në pretendimet që ngrenë mund të kenë të drejtë. Koha do ta tregojë. Por institucioni publik i auditimit më të lartë në vend e ka detyrë kushtetuese t'i konsiderojë të gjitha ditët e vitit njëloj në misionin e vet. Dhe të kryejë punën çdo ditë, me përkushtim, pa u ndikuar nga askënd, as edhe nga atmosfera festash. Për këtë duhet ta nxisim, dhe jo t'i themi: "Vëre dorën në zemër, mos na shqetëso ditën që do të hamë gjelin e Vitit të Ri. Mos na a ngec në grykë". Është një institucion që deri një vit më parë ka funksionuar si një OJF, duke kumtuar shkelje hipotetike dhe duke kryer çdo vit kallëzime penale që numeroheshin me gishtërinjtë e duarve, nga mbi 150 auditime të tij. KLSH ka ndryshuar. Vetëm vitin e kaluar dërgoi në Prokurori dy herë më shumë raste nga sa kishte çuar në tre vitet e mëparshme të marra së bashku. Pra, përgatiti dhe dërgoi 42 kallzime penale, kur në vitin 2011 institucioni kishte përgatitur e çuar vetëm 6. Ne si qytetarë e kemi të gjithë interesin ta nxisim në këtë punë që po bën. Të përkrahim institucionet e pavarura publike që kemi, kur ato përpiqen ta kryejnë detyrën dhe misionin e ngarkuar nga Kushtetuta apo ligje të tjera. Dhe KLSH misionin e ka sa të vështirë dhe delikat. Janë rreth 3 miliardë euro para publike që shpenzohen çdo vit nga Buxheti i Shtetit. KLSH duhet të shikojë mënyrën se si këto para shpenzohen. A është ky shpenzim në rregull me ligjet dhe rregullat financiare? A janë shpenzuar këto para me ekonomi, frytshmëri dhe leverdi? Në këtë detyrë institucioni nuk ka si të bëjë miq. Janë të paktë ata që e duan kritikën dhe kontrollin për të përmirësuar performancën. Institucioni, nëse do ta kryejë detyrën ashtu si duhet, do të ketë vetëm presione dhe tentativa për ta ndikuar të ulë tehun e kërkimit të llogarisë. Por qytetarët shpresojnë tek KLSH. Qytetarët duan agresivitet. I kanë sytë tek KLSH, sa herë nxjerr një rezultat kontrolli në media. Kërkojnë prej tij vëmendje dhe përkushtim maksimal ndaj mënyrës se si shpenzohen paratë që ata i paguajnë Shtetit, pra

fondet publike. Me njoftimet për shtyp dhe denoncimet gjatë gjithë vitit të kaluar, institucioni dhe veçanërisht Kryetari i KLSH po e tregojnë veten se dinë të respektojnë këtë ndjeshmëri, shpresë dhe pritshmëri popullore. Këto njoftime kanë qenë mirëfilli kartolina të përgjegjesisë publike, mesazhe se syri më i lartë dhe profesional vëzhgues dhe kontrollues i Shtetit po funksionon dhe do të jetë edhe më zbirues e llogarikërkues në të ardhmen. Dhe këtë gjë e duam të gjithë, duan apo s’duan menaxherët shtetërore qejfprishur në darkën e Vitit të Ri. Institucioni sapo njoftoi dje se dërgoi për kallzim penal dy ish-kontrollorë të tij, për falsifikim të dokumenteve shtetërore dhe dëmtim të rëndë të interesave të ligjshme të shtetit. Kur nuk fal të vetët, KLSH duket se e ka me tërë mend të na shërbejë ne qytetarëve të thjeshtë. Ka nevojë dhe le t’ia japim ndihmën e përkrahjen tonë, qofte dhe me një simpati spontane të shprehur duke pirë një kafe me shokët e miqtë.

ⁱ Botuar në gazetën “Metropol” datë 06 shkurt 2013.

ⁱⁱ Shkrime të tjera të autorit (të papërfshira në këtë botim) gjatë vitit 2013:

- Korrupsioni dhe roli i KLSH (Ekonomia, 10 prill 2013)
- KLSH e qytetarit dhe për qytetarin (Standard, 21 prill 2013)
- KLSH : Publikime me interes për të gjithë shoqërinë (Ekonomia, 25 prill 2013)
- KLSH-partneritet për ndryshim (Ekonomia, 02 maj 2013)
- KLSH-partneritet për ndryshim (Ekonomia, 03 maj 2013)
- KLSH zhvillon ndjeshëm burimet e tij njerëzore (Ekonomia, 19 maj 2013)
- Cilësia në auditim, arritje dhe sfide e KLSH (Ekonomia, 26 maj 2013)
- Nisma e KLSH për auditimin e brendshëm (Ekonomia, 13 qershor 2013)
- KLSH dhe bota akademike (Ekonomia, 18 qershor 2013)
- KLSH forcon lidhjet me SAI-t simotra (Ekonomia 10 korrik 2013)

-
- KLSH dhe lufta ne sistem kunder korrupsionit (Ekonomia 21 Korrik 2013)
 - KLSH lufton korrupsionin në system (Metropol 31 gusht 2013)
 - KLSH rrit ndjeshëm ritmin auditues (Ekonomia 03 shtator 2013)
 - KLSH rrit fuqinë audituese (Ekonomia 11 shtator 2013)
 - KLSH dhe përgjegjshmëria për zhvillimin ekonomik (Ekonomia 18 shtator 2013)
 - Vlera publike e KLSH (Ekonomia 25 shtator 2013)
 - KLSH, legjislativi dhe shoqëria civile (Ekonomia 05 tetor 2013)
 - Komisioni European vlerëson lart KLSH-në (Ekonomia 17 tetor 2013)
 - Integrimi është përgatitje dhe trajnime intensive (Ekonomia 25 tetor 2013)
 - KLSH dhe reforma administrative (Ekonomia 05 nentor 2013)
 - KLSH dhe përballimi i pasojave të krizës (Ekonomia 6 dhjetor 2013)